



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. 10/2017

RREGULLA PËR SKEMËN MBËSHTETËSE PËR GJENERATORËT E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGISË

27 Prill 2017

PËRMBAJTJA

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi	3
Neni 2 Përkufizimet dhe Interpretimet	3
KREU II GJENERATORËT E BRE-ve TË PRANUAR NË SKEMËN MBËSHTETËSE	5
Neni 3 Kriteret për pranim në Skemën Mbështetëse	5
Neni 4 Kufizimi i kapacitetit për pranim në Skemën Mbështetëse	5
Neni 5 Kërkesa për Pranim në Skemën Mbështetëse	6
Neni 6 Pranimi në Skemën Mbështetëse	6
Neni 7 Shqyrtimi i aplikacioneve të Skemës Mbështetëse	7
Neni 8 Regjistri i Skemës Mbështetëse	8
Neni 9 Tarifat sipas Skemës Mbështetëse	8
Neni 10 Përjashtimi dhe tërheqja nga Skema Mbështetëse	9
Neni 11 Të drejtat dhe detyrimet e gjeneratorëve të BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse	9
Neni 12 Garancitë	10
Neni 13 Financimi i Skemës Mbështetëse të BRE-ve	11
KREU III GJENERATORËT E BRE-ve SIPAS KORNIZËS SË RREGULLUAR	12
Neni 14 Korniza e Rregulluar	12
Neni 15 Të drejtat dhe detyrimet e gjeneratorëve të BRE sipas Kornizës së rregulluar	13
KREU IV INTEGRIMI I GJENERATORËVE TË BRE-ve	13
Neni 16 Integrimi i energjisë elektrike nga BRE	13
Neni 17 Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë	14
KREU V SKEMA MBËSHTETËSE PËR GJENERATORËT PËR VET-KONSUM TË BRE-ve	15
Neni 18 Parimet e gjeneratorëve për vetë-konsum të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë	15
Neni 19 Metodologjia e Llogaritjes	15
Neni 20 Aplikimi i gjeneratorëve për Vetë-konsum dhe procedura e kyçjes	16
KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	16
Neni 21 Dispozitat kalimtare	16
Neni 22 Ndryshimi	17
Neni 23 Interpretimi	17
Neni 24 Shfuqizimi	17
Neni 25 Hyrja në fuqi	18
SHTOJCA I - FORMULARI I APLIKIMIT PËR SKEMËN MBËSHTETËSE TË BRE-VE	19
SHTOJCA 2: FORMULARI I APLIKIMIT PËR KORNIZËN E RREGULLUAR TË BRE-VE	20
SHTOJCA 3: FORMULARI I APLIKIMIT PËR STATUS TË KONSUMATORIT PRODHUES	21

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë në përputhje me Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 05/L-084, dhe në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081, në seancën e mbajtur më [dita] [muaji] 2017 miratoi:

**Rregullën për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të
Ripërtëritshme të Energjisë
(Rregulla për Skemën Mbështetëse)**

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Rregulla për Skemën Mbështetëse për gjeneratorët e BRE-ve përcakton mekanizmat e rregulluar për mbështetjen e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme.
- 2 Kjo Rregull përcakton:
 - 2.1 Parimet e mbështetjes së gjeneratorëve të BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse;
 - 2.2 Kriteret për pranim në Skemën Mbështetëse të BRE-ve;
 - 2.3 Procedura e aplikimit për pranim në Skemën Mbështetëse të BRE-ve;
 - 2.4 Procedura për financimin e Skemës Mbështetëse të BRE-ve;
 - 2.5 Parimet e mbështetjes së gjeneratorëve të BRE-ve sipas Kornizës së Rregulluar.
 - 2.6 Parimet e mbështetjes së gjeneratorëve për vetë-konsum të BRE-ve;

Neni 2

Përkufizimet dhe Interpretimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 **Periudha e faturimit** - periudha mujore ndërmjet dy leximeve të njehsorit në lokacionin e gjeneratorit apo konsumatorit prodhues mbi bazën e të cilës fatura e asaj periudhe është nxjerr nga furnizuesi;
 - 1.2 **Direktiva 2009/28/KE** - Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme dhe ndryshimin si dhe rrjedhimisht shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE;

- 1.3 **OSSH**- është bartësi i licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- 1.4 **Zyra e Rregullatorit për Energji** – (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 1.5 **Garanci** është garancia e pakusht financiare e paguar nga Gjeneratori i BRE-ve dhe e mbajtur nga Operatori i Tregut, në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 12 të kësaj Rregulle;
- 1.6 **Gjenerator i madh i BRE-ve** nënkupton gjeneratorin e kyçur në rrjet, me kapacitet më të lartë se 100 kW (> 100 kW);
- 1.7 **Gjenerator i vogël i BRE-ve** nënkupton gjeneratorin e kyçur në rrjet me kapacitet deri në 100 kW (≤ 100 kW);
- 1.8 **OT** – është bartësi i licencës së Operatorit të Tregut;
- 1.9 **Konsumator prodhues**- është konsumatori i energjisë elektrike që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin lokacion është pronar i mikro-gjeneratorit të BRE-ve, të kyçur në rrjet dhe me të drejtë të vetë-konsumit të energjisë elektrike të gjeneruar si dhe dërgimin e tepcicës së energjisë elektrike të gjeneruar tek furnizuesi;
- 1.10 **Marrëveshje me konsumatorët prodhues**- marrëveshje e zhvilluar dhe aprovuar nga ZRRE, që është nënshkruar nga një furnizues dhe konsumator prodhues dhe e cila, ndër të tjera, specifikon termet dhe kushtet e marrjes të energjisë elektrike nga furnizuesi dhe konsumin e energjisë elektrike nga konsumatori prodhues si dhe të drejtat dhe obligimet e tyre;
- 1.11 **Bilanci i konsumatorëve prodhues**- është ndryshimi ndërmjet prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike, shprehur në kWh, brenda një periudhe të faturimit;
- 1.12 **Çmimi referent**- nënkupton, për çdo vit, çmimin që është ekuivalent me çmimin mesatar në treg, siç përcaktohet nga Rregullatori në baza vjetore;
- 1.13 **Korniza e rregulluar**- është korniza e rregulluar e aplikueshme për gjeneratorët e BRE-ve, të papranuar në Skemën Mbështetëse që nuk dëshirojnë të operojnë në treg të hapur;
- 1.14 **Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE)** – burimet e ripërtërishme jo-fosile të energjisë, si: hidroenergji, centralët e erës, solare, gjeotermale, valëve, bio-energji, biomasa dhe biogazet;
- 1.15 **Fondi për energjinë e ripërtërishme**- është fondi siç është përcaktuar në Nenin 13 të kësaj Rregulle;
- 1.16 **Gjeneratori i BRE-ve**- është gjeneratori që prodhon energji nga burimet e ripërtërishme të energjisë për të cilin është lëshuar një Certifikatë e Origjinës;
- 1.17 **Çaqet e BRE-ve**- Çaqet për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, siç janë përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë përmes një akti nën-ligjor;
- 1.18 **Gjeneratorët për Vetë-konsum**- janë konsumatorët prodhues që do të mund të ofrojnë energjinë e prodhuar në rrjetin e energjisë elektrike për konsum në të ardhmen ose t'i paguajnë furnizuesit energjinë e konsumuar në rast të bilancit negativ;
- 1.19 **OST**- bartësi i licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

- 2 Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregull do të kenë kuptimin e njëjtë sikurse në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Energjinë.

KREU II

GJENERATORËT E BRE-ve TË PRANUAR NË SKEMËN MBËSHTETËSE

Neni 3

Kriteret për pranim në Skemën Mbështetëse

- 1 Një gjenerator i BRE-ve është i kualifikueshëm për pranim në Skemën Mbështetëse nëse:
- 1.1 Është gjenerator i vogël ose i madh i BRE-ve që prodhon energji nga një ose më shumë burime primare të energjisë së ripërtëritshme, të përcaktuara në Caqet e BRE-ve;
 - 1.2 Ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës;
 - 1.3 Prodhon energji duke përdorur kapacitetet gjeneruese me pajisje të reja (me zero operim).

Neni 4

Kufizimi i kapacitetit për pranim në Skemën Mbështetëse

- 1 Vetëm aplikuesit që aplikojnë në Rregullator për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për gjenerim të energjisë elektrike në përputhje me Rregullën për Procedurën e Autorizimit, do të pranohen në Skemën Mbështetëse.
- 2 Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve që do të pranohen në Skemën Mbështetëse për gjenerim të energjisë nga energjia fotovoltaike duhet të jenë deri në, apo baraz me, 3 MW (≤ 3 MW).
- 3 Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve për pranim në Skemën Mbështetëse për gjenerim të energjisë elektrike nga biomasa e ngurtë duhet të jetë deri në, apo baraz me 14 MW (≤ 14 MW).
- 4 Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve për pranim në Skemën Mbështetëse për gjenerim të energjisë elektrike nga era duhet të jetë deri në, apo baraz me 35 MW (≤ 35 MW).
- 5 Kapaciteti i planifikuar në MW për hidrocentralet që do të pranohen në Skemën Mbështetëse për gjenerim të energjisë elektrike duhet të jetë deri në, apo baraz me 10 MW (≤ 10 MW).

Neni 5

Kërkesa për Pranim në Skemën Mbështetëse

- 1 Kërkesa me shkrim për pranim në Skemën Mbështetëse duhet të dorëzohet në Rregullator në pajtueshmëri me Shtojcën 1 të kësaj Rregulle.
- 2 Kërkesa për pranim në Skemën Mbështetëse duhet të plotësohet gjatë aplikimit për marrjen e Autorizimit, në përputhje me Rregullën për procedurën e autorizimit.
- 3 Të gjitha aplikacionet për marrjen e Autorizimit, të cilat nuk përmbajnë kërkesën për pranim në Skemën Mbështetëse, ose vazhdojnë të kërkojnë autorizimin për ndërtim, duke u tërhequr nga kërkesa për pranim në Skemën Mbështetëse, nuk do të pranohen në Skemën Mbështetëse në të ardhmen, në përputhje me këtë Rregull.

Neni 6

Pranimi në Skemën Mbështetëse

- 1 Me Njoftimin për Vendimin mbi Autorizimin Preliminar, brenda vendimit përkatës, Rregullatori duhet të përcaktoj nëse caqet janë të disponueshme që aplikanti të kualifikohet automatikisht për pranim në Skemën Mbështetëse.
- 2 Në rast se aplikuesi aplikon direkt për marrjen e Autorizimit Final dhe parashtrohet kërkesën për pranim në Skemën Mbështetëse, Rregullatori brenda vendimit përkatës do të përcaktoj nëse caqet janë të disponueshme, dhe aplikuesi kualifikohet për tu pranuar në mënyrë automatike në Skemën Mbështetëse.
- 3 Njoftimi mbi Vendimin për Autorizim Preliminar apo Autorizimi Final i lëshuar nga Rregullatori dhe që përcakton pranimin e aplikuesit në Skemën Mbështetëse, në mënyrë automatike garanton edhe Tarifën Nxitëse.
- 4 Kur ZRRE lëshon një Vendim për Autorizim Preliminar dhe Autorizimin Final, në përputhje me Rregullën për Procedurën e Autorizimit, me ç'rast janë përmbushur caqet e disponueshme, duhet të njoftoj të gjithë aplikuesit tjerë për përmbushjen e caqeve si dhe pamundësinë për të garantuar Tarifën Nxitëse sipas kësaj Rregulle.
- 5 Rregullatori do t'i konsideroj caqet si të përmbushura, atëherë kur janë lëshuar Vendimet për Autorizime Preliminare dhe Finale për kapacitetin e instaluar sipas Udhëzimit Administrativ përkatës për caqet e BRE-ve, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë. Pavarësisht caqeve vjetore, të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë, kapacitetet e reja mund të lëshohen në operim për të gjitha BRE-të deri në vitin 2020.
- 6 Në rastet kur aplikuesi vazhdon me procedurat për marrjen e Vendimit për Autorizim Preliminar dhe Autorizimit Final pa aplikuar për Skemën Mbështetëse, Rregullatori në vendimin e tij duhet

të specifikoj nëse aplikuesi nuk është më i kualifikueshëm për t'u përfshirë në Skemën Mbështetëse.

- 7 Nga momenti i plotësimit të caqeve të disponueshme, me rastin e lëshimit të Vendimeve për Autorizime Preliminare ose Finale, sipas kërkesave të gjeneratorëve të BRE-ve për hyrje në Skemën Mbështetëse, Rregullatori do të specifikoj në vendimet përkatëse se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës për përcaktimin e caqeve, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë. Rregullatori do t'i konsideroj këto aplikacione si aplikacione në "pritje", për pranim në Skemën Mbështetëse.
- 8 Aplikuesit të cilit i është lëshuar Vendimi për Autorizimin Preliminar apo Vendimi për Autorizimin Final me një shënim nga Rregullatori, sipas paragrafit 8 të Nenit 6 të kësaj Rregulle, afatet e përcaktuara me Rregullën për procedurën e autorizimit do të fillojnë të rrjedhin jo nga data e lëshimit të vendimit përkatës por nga data e njoftimit me shkrim nga Rregullatori për përfshirje në Skemën Mbështetëse.
- 9 Nga momenti i lirimit të caqeve të disponueshme të BRE-ve, aplikuesi në radhë të pritjes që ka Vendimin për Autorizimin Preliminar do të njoftohet me shkrim nga Rregullatori. Në rast se aplikuesi ka Vendimin për Autorizimin Preliminar për kapacitet më të lartë se caqet e liruara, aplikuesi do të ketë të drejtë të kërkoj që Vendimi për Autorizimin Preliminar të ndahet/modifikohet në atë mënyrë që i garantohet e drejta për caqet e liruara, ndërsa kapaciteti i mbetur mund të vazhdon të jetë "në pritje", sipas kërkesës së aplikuesit.
- 10 Nga momenti i lirimit të caqeve të disponueshme, aplikuesi në radhë të pritjes që ka Vendimin për Autorizimin final do të njoftohet me shkrim nga Rregullatori. Në rast se aplikuesi ka Autorizim Final për kapacitet më të lartë se caqet e liruara, aplikuesi do të pres deri sa të lirohen caqet e disponueshme apo të kërkoj modifikimin e Autorizimit Final. Pjesa e mbetur e kapacitetit nuk do të vazhdon të jetë "në pritje" sikurse është përcaktuar në Vendimin për Autorizimin Preliminar, të përcaktuar në këtë Nen.

Neni 7

Shqyrtimi i aplikacioneve të Skemës Mbështetëse

- 1 Rregullatori duhet të shqyrtoj përmbajtjen e Aplikacionit për pranim në Skemën Mbështetëse si dhe Aplikacionit për Autorizim.
- 2 Çdo ndryshim apo modifikim i kërkuar nga Rregullatori për pranim në Skemën Mbështetëse duhet të kërkohet gjatë vlerësimit të Aplikacionit për Autorizim, në përputhje me Rregullën për Procedurën e Autorizimit.

- 3 Rregullatori duhet të informoj aplikuesin lidhur me pranimin apo mospranimin në Skemën Mbështetëse, me Vendimin për Autorizim. Në rast se aplikacioni është refuzuar, Rregullatori duhet të jap arsye që kanë rezultuar në një refuzim të tillë.

Neni 8

Regjistri i Skemës Mbështetëse

- 1 Rregullatori duhet të krijoj dhe vazhdimisht të azhurnoj regjistrin e Skemës Mbështetëse për energjinë elektrike të gjeneruar nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- 2 Rregullatori duhet të krijoj një regjistër i cili do të përmbaj aplikacionet e pranuar në Skemën Mbështetëse dhe gjeneratorët e BRE-ve që janë në pritje për pranim në Skemën Mbështetëse.
- 3 Aplikacionet që konsiderohen si “aplikacione në pritje” do të regjistrohen në listën e pritjes, sipas datës së lëshimit të Vendimit për Autorizim Preliminar apo Autorizimit Final.
- 4 Gjatë krijimit të regjistrin dhe zbatimit të procedurave të “aplikacioneve në pritje” për pranim në Skemën Mbështetëse, ZRRE duhet t’i trajtoj në mënyrë të barabartë poseduesit e Vendimeve për Autorizime Preliminare apo Autorizime Finale dhe duhet të veproj sipas renditjes kronologjike në regjistër.
- 5 Me rastin e lirit të caqeve të disponueshme, ZRRE do t’i njoftoj aplikuesit të cilët janë të regjistruar në listën e pritjes, sipas rendit të aplikacioneve të tyre.
- 6 Regjistri për Skemën Mbështetëse do të publikohet në faqen elektronike të Rregullatorit dhe do të azhurnohet në bazë të aplikacioneve të reja.

Neni 9

Tarifat sipas Skemës Mbështetëse

- 1 Rregullatori duhet të përcaktoj tarifin, që janë të aplikueshme ndaras për energjinë elektrike të prodhuar nga Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse, që mund të jenë tarifa nxitëse (Feed-in Tariff apo Feed-in Premium dhe forma tjera të mbështetjes) dhe ndaras për Gjeneratorët sipas Kornizës së Rregulluar.
- 2 Me vendim përkatës, tarifin e përmendura në paragrafin 1 të këtij Neni, duhet të përshtaten me inflacionin në baza vjetore, pas vitit të parë të operimit. Datat e sakta për mënyrën korrekte për aplikimin e inflacionit duhet të përcaktohen nga Marrëveshja për Blerjen e Energjisë (MBE). Norma e inflacionit do të përcaktohet nga norma e ndryshimit gjatë 12 muajve të fundit, në nivelin e “Çmimeve të produktit industrial të brendshëm – mallrave kapitale NACE Rev2”, indeksi për shtetet e Eurozonës, të publikuar nga Eurostat.

Neni 10

Përfashtimi dhe tërheqja nga Skema Mbështetëse

- 1 Gjeneratorët e BRE-ve do të përfashtohen nga Skema Mbështetëse nëse:
 - 1.1 Gjeneratori i BRE-ve dështon në marrjen e Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese, në përputhje me Rregullën për Procedurën e Autorizimit;
 - 1.2 Gjeneratori i BRE-ve dështon të hyj në operim brenda gjashtë (6) muajsh nga ekzekutimi i Garancisë së referuar në Nenin 12 të kësaj Rregulle.
- 2 Gjeneratori i BRE-ve, i pranuar në Skemën Mbështetëse mund të tërhiqet nga Skema Mbështetëse me anë të një kërkesë me shkrim dërguar Rregullatorit nga operatori gjenerator.
- 3 ZRRE konfirmon tërheqjen e operatorëve gjenerues nga Skema Mbështetëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kërkesës dhe e fshinë njësinë gjeneruese nga Regjistri i njësive të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 4 Operatori gjenerues i cili përfashtohet ose tërhiqet nga Skema Mbështetëse nuk është i kualifikueshëm të aplikoj për riparim në Skemë në ndonjë datë të mëvonshme për të njëjtin lokacion (gjenerator).

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e gjeneratorëve të BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse

- 1 Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse duhet:
 - 1.1 Të kenë të drejtë të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut përmes një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë për një periudhë 10 deri në 12 vjeçare, varësisht nga teknologjia dhe me çmim të Tarifës nxitëse;
 - 1.2 Të jenë përgjegjës për 25% të kostove totale të imbalancit, përveq Gjeneratorëve të BRE me kapacitet të instaluar nën 500 kW;
 - 1.3 Të kenë prioritet në ekzaminimin e aplikacionit për kyçje në sistemin relevant;
 - 1.4 Të kenë të drejtën e prioritetit në dispeçim.
- 2 Shitja e energjisë elektrike tek OT duhet të mbulohet nga Marrëveshja për Blerjen e Energjisë, e cila lidhet ndërmjet gjeneratorit të BRE-ve dhe Operatorit të Tregut.
- 3 Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë (hidroenergji dhe biomasa solide) do të kenë kohëzgjatje prej dhjetë (10) vitesh, ndërsa Marrëveshja për Blerjen e Energjisë (MBE) për energjinë elektrike të gjeneruar nga panelet fotovoltaike dhe gjeneratorët e erës do të ketë kohëzgjatjen 12 vjeçare, me çmime (tarifa nxitëse) përkatëse, të aplikueshme në Skemën Mbështetëse.

- 4 MBE u garantohet të gjitha njërive gjeneruese që janë pranuar në Skemën Mbështetëse, dhe në përputhje me këtë rregull duhet të lidhen MBE me OT brenda tridhjetë (30) ditë pas pranimit në Skemën Mbështetëse, me të drejtë të operimit komercial sipas paragrafit 7 të këtij neni.
- 5 Çmimi i tarifës nxitëse i gjeneratorit të BRE-ve duhet të jetë çmimi i aplikueshëm në kohën e pranimit në Skemën Mbështetëse. Çdo ndryshim i ardhshëm i Tarifës nxitëse nuk do të ndikoj gjeneratorët e BRE-ve tashmë të pranuar në Skemën Mbështetëse
- 6 Brenda tridhjetë (30) ditësh pune nga pranimi në Skemën Mbështetëse, Gjeneratori i BRE-ve duhet të paguaj garancinë, në përputhje me Nenin 12 të kësaj rregulle. Pranimi në Skemën Mbështetëse do të jetë efektiv nga data e pagesës së kësaj garancie.
- 7 Gjeneratori i BRE-ve duhet të hyj në operim brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit teknik dhe lëshimit të Certifikatës së Përdorimit të lëshuar nga organi kompetent.

Neni 12

Garancitë

- 1 Garancia e referuar në Nenin 11, paragrafi 6 i kësaj rregulle, duhet të ketë një periudhë të vlefshmërisë sa ka afat Autorizimi Final i lëshuar sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit në favor të Operatorit të Tregut, nëse nuk ekzekutohet, lirohet dhe i kthehet gjeneratorit të BRE-ve.
- 2 Niveli i Garancisë duhet të llogaritet si qarkullim që gjeneratori i BRE-ve i pranuar në Skemën Mbështetëse do të pritej ta merrte për një periudhë tre (3) mujore, duke marrë parasysh:
 - 2.1 Çmimet e njërive relevante ndaj burimit primar të energjisë të përdorur nga gjeneratori i BRE-ve i pranuar në Skemën Mbështetëse;
 - 2.2 Kapacitetin e instaluar të gjeneratorit të BRE-ve;
 - 2.3 Faktorin mesatar të kapacitetit të pritur të burimit primar të energjisë, siç është përcaktuar nga një institucion relevant në Kosovë,
- 3 Niveli i Garancisë duhet të konfirmohet nga ZRRE para dorëzimit.
- 4 Garancia e dorëzuar nga gjeneratori i BRE-ve i pranuar në Skemën Mbështetëse mbahet nga Operatori i Tregut.
- 5 Nëse gjeneratori i BRE-ve i pranuar në Skemën Mbështetëse dështon të hyj në operim deri në datën e caktuar nga Rregullatori në përputhje me Nenin 11, paragrafi 7 të kësaj Rregulle, atëherë duhet të ekzekutohet Garancia e referuar në Nenin 11 paragrafi 6 të kësaj rregulle në llogarinë e Operatorit të Tregut.

- 6 Nëse gjeneratori i BRE-ve kërkon përjashtim nga Skema Mbështetëse e BRE-ve, në përputhje me Nenin 10, paragrafin 2 të kësaj Rregulle, Garancia e paguar nga Gjeneratorit i BRE-ve duhet të lirohet dhe t'i kthehet gjeneratorit të BRE-ve.

Neni 13

Financimi i Skemës Mbështetëse të BRE-ve

- 1 Kostot shtesë të shkaktuara për të mbështetur zhvillimin e projekteve nga BRE-të, të pranuar në Skemën Mbështetëse, kompensohen nëpërmjet Fondit për Energjinë e Ripërtëritshme, i menaxhuar nga OT. OT i raporton Rregullatorit për operimin e Fondit për Energjinë e Ripërtëritshme në baza tremujore.
- 2 Fondi për Energjinë e Ripërtëritshme shfrytëzohet për të financuar kostot lidhur me:
- 2.1 Dallimin ndërmjet çmimit referent dhe tarifës nxitëse;
 - 2.2 Kompensimin për kostot e imbalancit për të reflektuar dispozitat në Nenin 11, paragrafi 1.2 të kësaj Rregulle;
 - 2.3 Kostot e shkaktuara nga OT për menaxhimin dhe operimin e fondit si dhe çdo kosto tjetër e nevojshme për implementimin e kësaj Rregulle, nëse ashtu vendoset nga Rregullatori.
- 3 Financimi i Fondit për Energjinë e Ripërtëritshme mundësohet përmes një Tarife për Energjinë e Ripërtëritshme, e aplikuar në nivel të transmetimit për të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike në Kosovë, llogaritur sipas formulës në vijim:

$$REC_t = ((FIT_t - RP_t) \cdot Q_t + I_t + MO_t - G_{t-1} \pm \Delta CF_{t-1}) / NP_t$$

Ku:

REC_t	<i>Tarifa për Energjinë e Ripërtëritshme</i>
FIT_t	<i>Tarifa Nxitëse e aplikuar për secilën teknologji relevante në vitin t</i>
RP_t	<i>Çmimi referent për vitin t, ekuivalent me çmimin mesatar të tregut siç përcaktohet në baza vjetore nga Rregullatori</i>
Q_t	<i>Energjia elektrike e parashikuar, dorëzuar nga secila teknologji relevante në vitin t</i>
I_t	<i>Kosto e parashikuar e imbalancit, e lejuar nga Rregullatori në vitin t</i>
G_{t-1}	<i>Vlera e garancionit financiar në vitin t-1</i>
ΔCF_{t-1}	<i>Faktori korrektues ndërmjet vlerave të lejuara dhe atyre ekzistuese në vitin t</i>

NP_t	<i>Neto-konsumi i parashikuar i energjisë në vitin relevant t</i>
MO_t	<i>Kostoja e parashikuar e shkaktuar nga OT për menaxhimin dhe operimin e Fondit në vitin t, duke përfshirë kostot e kapitalit punues dhe çdo kosto tjetër të veprimit të vendosur në mënyrë retroaktive.</i>
t	<i>Viti relevant</i>

- 4 OT shpërndan gjithë prodhimin e BRE-ve tek furnizuesit, në proporcion me kërkesën e tyre individuale në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë.
- 5 Kostot bazë të energjisë elektrike nga BRE-të, të cilat nuk mbulohen përmes Tarifës për energjinë e ripërtëritshme, dhe të cilat janë ekuivalente me shumën e çmimit përkatës dhe kapacitetin e energjisë elektrike të shpërndarë tek secili furnizues, duhet të mbulohen nga fatura të veçanta të lëshuara nga OT tek secili furnizues, sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

KREU III
GJENERATORËT E BRE-ve SIPAS KORNIZËS SË RREGULLUAR

Neni 14
Korniza e Rregulluar

- 1 Gjeneratorët e vegjël dhe të mëdhenj të BRE-ve të cilët nuk janë në Skemën Mbështetëse mund të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike sipas Kornizës së Rregulluar ose sipas kushteve të parregulluara të bazuara në treg.
- 2 Gjeneratorët e BRE-ve që dëshirojnë të operojnë sipas Kornizës së Rregulluar, duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim në Rregullator, në përputhje me Shtojcën 2 të kësaj Rregulle.
- 3 Rregullatori duhet të informoj gjeneratorin e BRE-ve nëse kërkesa për pranim në Kornizën e Rregulluar është aprovuar apo refuzuar. Në rast të refuzimit të Aplikacionit, Rregullatori duhet të jap arsyt që kanë rezultuar në një refuzim të tillë.
- 4 Një gjenerator i BRE-ve i pranuar në Kornizën e Rregulluar mund të tërhiqet nga Korniza e Rregulluar me një kërkesë me shkrim, drejtuar Rregullator.
- 5 Gjeneratori i BRE-ve i cili është përjashtuar apo është tërhequr me kërkesën e tij nga Korniza e Rregulluar nuk lejohet të aplikoj për ripranim në Kornizën e Rregulluar në ndonjë datë të mëvonshme.

Neni 15

Të drejtat dhe detyrimet e gjeneratorëve të BRE sipas Kornizës së rregulluar

- 1 Gjeneratorët e BRE-ve të papranuar në Skemën Mbështetëse që zgjedhin të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike sipas Kornizës së Rregulluar, duhet:
 - 1.1. Të kenë të drejtë të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut përmes një Marrëveshjeje për Blerje të Energjisë me çmim përkatës(referente) të përcaktuar nga ZRRE në baza vjetore;
 - 1.2. Të jenë përgjegjës për të gjitha kostot e tyre të jobalancit përveç Gjeneratorëve të BRE me kapacitet të instaluar nën 500 kW;
 - 1.3. Të kenë prioritet në vlerësimin e aplikacionit për kyçje në sistemin relevant;
 - 1.4. Të kenë prioritet në dispeçim.
- 2 Shitja e energjisë tek Operatori i Tregut duhet të mbulohet nga një Marrëveshje për Blerje të Energjisë, e cila duhet të lidhet ndërmjet gjeneratorit të BRE-ve sipas Kornizës së Rregulluar dhe Operatorit të Tregut.
- 3 Marrëveshjet për Blerje të Energjisë për gjeneratorët e BRE-ve sipas Kornizës së Rregulluar duhet të ketë një kohëzgjatje minimum prej një (1) viti dhe mund të zgjas për gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës së gjeneratorit të BRE-ve të lëshuar nga Rregullatori. Nëse operatorit të BRE-ve nuk i kërkohet të marr licencë për gjenerim, kohëzgjatja e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë duhet të jetë e kufizuar në një maksimum prej pesëmbëdhjetë (15) viteve.

KREU IV

INTEGRIMI I GJENERATORËVE TË BRE-ve

Neni 16

Integrimi i energjisë elektrike nga BRE

- 1 OST i jep përparësi dispeçimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, për të cilat do të lëshohen Certifikatat e Origjinës dhe rrjedhimisht energjisë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 2 Njësitë gjeneruese të cilat prodhojnë energji elektrike nga BRE, u nënshtrohen dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Kodit të Pajisjeve Elektrike, Kodit të Shpërndarjes, Rregullave të Tregut dhe çdo kodi ose rregulle tjetër të aplikueshme, përveç nëse në mënyrë specifike trajtohet ndryshe në këtë Rregull.
- 3 OST dhe OSSH i japin prioritet vlerësimit të aplikacionit për kyçje të dorëzuar nga njësitë gjeneruese që prodhojnë energji elektrike nga BRE, në mënyrë që të zvogëlohet sa më shumë që

të jetë e mundur koha e nevojshme për arritjen e marrëveshjes së kyçjes dhe për kompletimin e kyçjes.

Neni 17

Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë

- 1 OT harton Marrëveshjet për Blerje të Energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose sipas Kornizës së Rregulluar.
- 2 OT harton Marrëveshjen për Blerje të Energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të dhe të pranuar në Skemën Mbështetëse ose në kuadër të Kornizës së Rregulluar me furnizuesit.
- 3 Marrëveshjet për Blerje të Energjisë duhet të përfshijnë dispozita në bazë të të cilave gjeneratori i BRE-ve i pranuar në Skemën Mbështetëse ose në kuadër të Kornizës së rregulluar zotohet se do të veprojnë në përputhje me obligimet e përcaktuara përgjatë tërë kohëzgjatjes së marrëveshjes.
- 4 MBA-të e përgatitura sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij Neni duhet të miratohen nga Rregullatori, pas një konsultimi me palët e treta. Rregullatori mund të udhëzojë OT-në në çdo moment para nënshkrimit të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, në mënyrë që të bëjë ndryshimet në draft, varësisht nëse e sheh të arsyeshme.
- 5 Gjeneratori i BRE-ve dhe OT duhet të nënshkruajnë Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë brenda tridhjetë (30) Ditëve nga data e Pranimit në Skemën Mbështetëse apo në Kornizën e Rregulluar.
- 6 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh para fillimit të operimi komercial të gjeneratorit sipas nenit 11 paragrafi 7 i kësaj Rregulle, OT duhet të informoj OST/ Rregullatorin, dhe kur është e nevojshme edhe OSSH-në, për datën në të cilën hyn në fuqi komerciale Marrëveshja për Blerje të Energjisë, për të aktivizuar procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të njehsimit (matjes).
- 7 Shkëputja e MBE-së nga ndonjëra nga palët kontraktuese sipas legjislacionit në fuqi ka si rrjedhojë përjashtimin e operatorit gjenerues nga Skema Mbështetëse dhe fshirjen e tij nga Regjistri i njësive të pranuar në Skemën Mbështetëse
- 8 OT e njofton furnizuesin për nivelin e obligueshëm të garancisë që duhet të paguhet në një bankë në Kosovë në kesh apo letërgarancion dhe e cila duhet llogaritur deri në 11.5% të pagesave totale vjetore.

KREU V
SKEMA MBËSHTETËSE PËR GJENERATORËT PËR VET-KONSUM TË BRE-ve

Neni 18

Parimet e gjeneratorëve për vetë-konsum të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

- 1 Konsumatorët e energjisë elektrike që ndërtojnë gjenerator për vet-konsum të BRE-ve, mund të zgjedhin të mbajnë statusin e konsumatorëve prodhues, përmes një Skeme Mbështetëse për Vetë-konsum, të specifikuar në këtë Rregull.
- 2 Skema Mbështetëse për Vetë-konsum parasheh që:
 - 2.1. Furnizuesit marrin gjithë energjinë elektrike të prodhuar dhe e dërgojnë gjithë energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët prodhues, brenda një periudhe të faturimit;
 - 2.2. Furnizuesit llogarisin Bilancin e konsumatorëve prodhues të periudhës së faturimit, sipas të cilit përgatitet fatura mujore;
 - 2.3. Nëse Bilanci i konsumatorëve prodhues është pozitiv atëherë konsumatori prodhues, kreditohet në energji (kWh) në periudhën e ardhshme faturuese;
 - 2.4. Çdo bilanc pozitiv i papaguar në periudhën e fundit të faturimit të vitit kalendarik rifillon nga zero pa kompensim nga Furnizuesi;
 - 2.5. Nëse Bilanci i konsumatorëve prodhues është negativ, atëherë Furnizuesi faturon konsumatorin prodhues për vlerën e Bilancit vetë-prodhues.
- 3 Furnizuesit detyrohen të hyjnë në Marrëveshje për vetë-prodhim me çdo konsumator prodhues me të cilin kanë kontratë për furnizim me energji elektrike sipas termeve dhe kushteve të specifikuara në këtë Rregull.
- 4 Marrëveshja për vetë-prodhim, mes tjerash, përcakton obligimin e furnizuesit për marrjen e gjithë prodhimit të energjisë elektrike të gjeneruar nga konsumatori prodhues.

Neni 19

Metodologjia e Llogaritjes

- 1 Brenda secilës periudhë të faturimit, Bilancet negative i faturohen konsumatorit prodhues nga furnizuesi;
- 2 Bilanci total negativ do të shpërndahet ndërmjet kohës së pikut dhe jashtë-pikut në proporcion me alokimin aktual mujor të totalit të energjisë elektrike të konsumuar brenda periudhës së njëjtë të faturimit.

- 3 Brenda secilës periudhë të faturimit, bilancet pozitive u kreditohen konsumatorëve prodhues, në energji, për bilancin e periudhës së ardhshme të faturimit.
- 4 Çdo bilanc pozitiv i papaguar në periudhën e fundit të faturimit të vitit kalendarik rifillon nga zero (0 kWh) pa kompensim nga Furnizuesi;

Neni 20

Aplikimi i gjeneratorëve për Vetë-konsum dhe procedura e kyçjes

- 1 Çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët të rrjetit të shpërndarjes mund të aplikoj tek furnizuesi i tij për marrjen e statutit të konsumatorit prodhues, në përputhje me nenit 27 të Rregullës së Procedurës së Autorizimit dhe në përputhje me formularin e aplikimit në Shtojcën 3 dhe të njëjtin aplikacion duhet ta dorëzojë në Rregullator.
- 2 Furnizuesi e informon OSSH-në, brenda dhjetë (10) ditësh pune të pranimit të aplikacionit të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni.
- 3 Brenda dhjetë (10) ditësh pune pas pranimit të njoftimit, OSSH lëshon kushtet e kyçjes, përfshirë kërkesat e nevojshme për kyçje me të cilat konsumatori prodhues duhet të pajtohet në mënyrë që të implementoj këtë Rregull.
- 4 Me rastin e konfirmimit të pranimit teknik të kyçjes, furnizuesi i dorëzon konsumatorit - prodhues një kopje të Marrëveshjes, e cila nënshkruhet jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas dorëzimit të saj.
- 5 Brenda tre (3) muajsh nga miratimi i kësaj Rregulle, OSSH transponon çdo ndryshim të nevojshëm në legjislacionin, i domosdoshëm për implementimin e kësaj Rregulle.

KREU VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Dispozitat kalimtare

- 1 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, aplikuesit të cilët posedojnë Vendim për Autorizimin Preliminar apo Autorizime Finale, të cilat janë lëshuar sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit para hyrjes në fuqi të kësaj rregulle, do të bëjnë kërkesë me shkrim në OT për të lidhur marrëveshjen për Blerje të Energjisë, në përjashtim të neni 12 të kësaj Rregulle.
- 2 Marrëveshjet ekzistuese për Blerje të Energjisë Elektrike që janë të lidhura në mes të furnizuesit KESCO SH.A dhe Gjeneratorëve të BRE-ve, të ndërtuara përmes Rregullës për procedurën e autorizimit dhe që janë të Pranuar në Skemën Mbështetëse do të barten nga KESCO SH.A. në

OT, më largu deri me 31 dhjetor 2017, OT dhe gjeneratorët ekzistues të BRE-ve, do të lidhin MBA-në e aprovuar sipas kësaj Rregulle, dhe e cila do të jetë e vlefshme vetëm për periudhën e mbetur të saj.

- 3 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga miratimi i kësaj Rregulle, Rregullatori do të rregullon transferimin e financimit të gjeneratorëve të BRE-ve që kanë një Marrëveshje ekzistuese për Blerje të Energjisë me një furnizues në detyrë.
- 4 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, OST dhe OSSH duhet t'i dërgojnë ZRRE-së propozimet për ndryshimet e nevojshme në Kodin e Rrjetit dhe kodet e tjera teknike për zbatimin e dispozitave që përmban kjo Rregull.
- 5 Brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, OST i dorëzon ZRRE-se propozimet për ndryshimet e nevojshme në Kodin e Rrjetit dhe kodet e tjera teknike për implementimin e dispozitave të kësaj Rregulle.
- 6 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, OT i dorëzon Rregullatorit propozimet për ndryshimet e nevojshme në kodet relevante për miratimin e parimeve të Fondit të Energjisë së Ripërtëritshme.
- 7 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, OSSH i dorëzon Rregullatorit propozimet për ndryshimet e nevojshme në Kodin e Shpërndarjes për implementimin e dispozitave të kësaj Rregulle.

Neni 22

Ndryshimi

- 1 Rregullatori mund të ndryshoj ose modifikoj çdo dispozitë të kësaj rregulle.
- 2 Procedurat për modifikimin apo ndryshimin e kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 23

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të ofroj informacione sqaruese.

Neni 24

Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullën për Skemën Mbështetëse (për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtitëshme të Energjisë), të nxjerr në bazë të Ligjit për

Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 23 dhjetor 2014.


Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji :



Krenar Bujupi, u.d kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfi, anëtar

SHTOJCA I - FORMULARI I APLIKIMIT PËR SKEMËN MBËSHTETËSE TË BRE-VE

Detaje të aplikuesit				
Emri				
Adresa				
Personi kontaktues			Pozicioni	
Nr. tel.		Nr. faks.	E-mail	
Detaje të njësisë gjeneruese				
Emri			Lokacioni	
Kapaciteti i instaluar (MW)			Prodhimi i pritur vjetor (MWh)	
Në rast të prodhimit të kombinuar me lëndë djegëse konvencionale, paraqitet vetëm kapaciteti i BRE-ve				
Burimet primare të Energjisë së Ripërtërithme				
Burimet	Teknologjia	Lloji	Shëno me X	Shënime shtesë.
Erë	Turbinë e erës			
Diellore	Fotovoltaike			
Uji	Hidro	Me Rezervar		
		Mbi lumë (rrjedhëse)		
Biomasa	Bimë energjetike			
	Nënproduktet pyjore dhe bujqësore dhe mbetjet			
	Biogaz	Gazi i deponive		
		Gazi i kanaleve të ujërave të zeza		
		Të tjera		
	Energjia nga nënprodukte t dhe mbetjet	Mbetjet komunale të ngurta		
Nënproduktet industriale dhe mbetjet komerciale				
Vendi dhe data			Nënshkrimi	

SHTOJCA 2: FORMULARI I APLIKIMIT PËR KORNIZËN E RREGULLUAR TË BRE-VE

Detajet e aplikuesit				
Emri				
Adresa				
Personi kontaktues			Pozita	
Nr. Tel.	Nr. Fax.		E-mail	
Detaje për Gjeneratorin				
Emeri			Lokacioni	
Kapaciteti i instaluar (MW) Në rast të prodhimit të kombinuar me lëndë djegëse konvencionale, paraqitet vetëm kapaciteti i BRE-se			Prodhimi i pritur vjetor (MWh)	
Burimet Primare të Energjisë së Ripërtëritshme				
Burimi	Teknologjia	Shëno me x	Shënime shtesë	
Era	Turbinë e erës	<input type="checkbox"/>		
Diellore	Fotovoltaike	<input type="checkbox"/>		
Uji	Me rezervar	<input type="checkbox"/>		
	Mbi lum (rrjedhëse)	<input type="checkbox"/>		
Biomasa	Bimë energjetike	<input type="checkbox"/>		
	Nënproduktet pyjore dhe bujqësore dhe mbetjet	<input type="checkbox"/>		
	Biogaz	Gazi i deponive	<input type="checkbox"/>	
		Gazi i kanaleve të ujërave të zeza	<input type="checkbox"/>	
		Të tjera	<input type="checkbox"/>	
	Energjia nga nënproduktet dhe mbetjet	Mbetjet komunale të ngurta	<input type="checkbox"/>	
Nënproduktet industriale dhe mbetjet komerciale		<input type="checkbox"/>		
Vendi dhe data			Nënshkrimi	

SHTOJCA 3: FORMULARI I APLIKIMIT PËR STATUS TË KONSUMATORIT PRODHUES

Detajet e aplikuesit			
Emri			
Adresa			
Personi kontaktues		Numri referent i njehsorit	
Nr. tel	Nr. fax	E-mail	
Detajet e Gjeneratorëve			
Emri		Lokacioni	
Kapaciteti i instaluar (kW)		Prodhimi i pritur vjetor (kWh)	
Në rast të prodhimit të kombinuar me lëndë djegëse konvencionale, paraqitet vetëm kapaciteti i BRE-se			
Burimi Primar i Energjisë së Ripërtërtishme			
Burimi	Teknologjia	Shëno me x	Shënime shtesë
Diellore	Fotovoltaike	<input type="checkbox"/>	
Të tjera	Specifiko teknologjinë	<input type="checkbox"/>	
Vendi dhe data		Nënshkrimi	